

VENDIM
Nr. 528, datë 24.6.2020

**PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE
TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, NË FUNKSION TË PROCESIT TË
RINDËRTIMIT NË ZONËN 1/1 TË RE PËR ZHVILLIM, NË NJËSINË
ADMINISTRATIVE THUMANË, BASHKIA KRUJË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës; të neneve 5, pika 1, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, të ndryshuar; të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”; të vendimit nr. 7, datë 6.1.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për kushtet dhe procedurat për shpronësimet, për interes publik, në funksion të procesit të rindërtimit”, të vendimit nr. 8, datë 6.1.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kushteve dhe të kriterëve të përfitimit të sipërfaqeve ndërtimore në objektet e reja për banim nga subjektet që posedojnë ndërtime të klasifikuara si ndërtime pa leje” dhe të vendimit nr. 44, datë 22.1.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për shpalljen e zonës së re për zhvillim në Njësinë Administrative Thumanë, Bashkia Krujë, dhe caktimin e Fondit Shqiptar të Zhvillimit, si njësi zbatuese”, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, në funksion të procesit të rindërtimit, që do të realizohet në zonën 1/1, Njësia Administrative Thumanë, Bashkia Krujë, sipas tabelës bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Shpronësimi të bëhet në favor të Bashkisë Krujë.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme që shpronësohen të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për pasuritë e llojit tokë “arë” dhe “kultura bujqësore”, në shumën 20 932 039 (njëzet milionë e nëntëqind e tridhjetë e dy mijë e tridhjetë e nëntë) lekë.

4. Vlera e përgjithshme e kompensimit, prej 20 932 039 (njëzet milionë e nëntëqind e tridhjetë e dy mijë e tridhjetë e nëntë) lekësh, të përballohet nga zëri “Fondi për rindërtimin”, i miratuar për vitin 2020.

5. Shpenzimet procedurale, në vlerën 70 000 (shtatëdhjetë mijë) lekë, të përballohen nga buxheti i vitit 2020, miratuar për Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë.

6. Pronarët e pasqyruar në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi të kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur certifikatën e pronësisë origjinale ose dublikatë, kartelën e pasurisë të rifreskuar, si dhe hartën treguese të regjistrimit pranë Bashkisë Krujë, referuar aktmarrëveshjes së lidhur.

7. Shpronësimi të fillojë menjëherë nga hyrja në fuqi e këtij vendimi.

8. Bashkia Krujë, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi, t’i kërkojë Agjencisë Shtetërore të Kadastrës të kryejë regjistrimin e pasurive, pronë private, të shpronësuara, sipas legjislacionit në fuqi dhe referuar aktmarrëveshjes së lidhur.

9. Drejtoria e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës pranë Këshillit të Qarkut Durrës, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e hyrjes në fuqi të vendimit, të pasqyrojë në regjistrat kadastralë ndryshimin e kategorisë së resursit të pasurive të paluajtshme nga kategoria e resursit “tokë bujqësore” në kategorinë “tokë urbane” truall.

10. Gjatë periudhës së zbatimit të projektit (përfundimin e punimeve) qytetarët, nëse nuk kanë në pronësi ose në posedim objekte të tjera banimi, do të strehohen nga njësi e vetëqeverisjes vendore, nëpërmjet programeve të rindërtimit, të parashikuara në aktin normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore” ose në legjislacionin në fuqi për strehimin social.

11. Agjencia Shtetërore e Kadastrës të pezullojë të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuara, deri në momentin kur do të realizohen procesi i hedhjes së gjurmës së projektit mbi hartat kadastrale dhe kalimi i pronësisë në favor të Bashkisë Krujë për pasuritë e shpronësuara.

12. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Fondi Shqiptar i Zhvillimit dhe Bashkia Krujë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

LISTA EMËRORE E PRONARËVE, QË SHPRONËSOHEN PËR INTERES PUBLIK,
NË FUNKSION TË PROCESIT TË RINDËRTIMIT, PËR SHIPALLJEN E ZONËS 1/1 TË RE PËR ZHVILLIM, NË NJËSINË ADMINISTRATIVE THUMANË, BASHKIA KRUIJË

Nr.	STATUSI JURIDIK			SHTET	TË DHËNAT (mbi pasurinë, sipas ASHK - Kruijë)				VLERËSIMET PËR SHPRONËSIM, SIPAS LLOJIT TË PASURISË				Dokumenti i pronësisë	Kompensim	VLERA TOTALE (lek)	SHËNIME
	PRIVAT				Zona kadastrale	Nr. pas.	Lloji i pas.	Sip. totale (m ²)	Shpronësim tokë "arë"			Vegetacion Vlera (lek)				
	Emri	Atësia	Mbiemri						Sip. (m ²)	Çmimi (lek/ m ²)	Vlera (lek)					
1	MEREMË	TARE	ZIRA		3599 THUMANË	12/3	ARË	2800	2800	442	1,237,600		Kartela e Pasurisë së Paluajtshme	√	1,237,600	
2	NEZIR	ADEM	ZIRA		3599 THUMANË	12/2	ARË	1400	1400	442	618,800	348,529	Kartela e Pasurisë së Paluajtshme	√	967,329	
3	XHEMAL	ADEM	ZIRA		3599 THUMANË	12/8	ARË	2600	2600	442	1,149,200		Kartela e Pasurisë së Paluajtshme	√	1,149,200	
4	VATH	NEZIR	UKA		3600 THUMANË	12/7	ARË	2450	2450	442	1,082,900		Kartela e Pasurisë së Paluajtshme	√	1,082,900	
5				SHTET	3599 THUMANË	12/6	ARË	2300	0	442	-		Kartela e Pasurisë së Paluajtshme		-	
6				SHTET	3599 THUMANË	25/1	ARË	4100	0	442	-		Kartela e Pasurisë së Paluajtshme		-	
7	NAFIE ALMA EGLANTINA TEUTA ALFRED SONILA KLEVIS	SALI ISMAIL ISMAIL ISMAIL ISMAIL ISMAIL	ZIRA ZIRA ZIRA ZIRA ZIRA ZIRA		3599 THUMANË	25/2	ARË	3080	3080	442	1,361,360		Kartela e Pasurisë së Paluajtshme	√	1,361,360	
8	QAZIM	NEZIR	ZIRA		3599 THUMANË	26/4	ARË	3020	3020	442	1,334,840		Kartela e Pasurisë së Paluajtshme	√	1,334,840	
9	ASTRIT	ADEM	ZIRA		3599 THUMANË	26/5	ARË	2280	2280	442	1,007,760		Kartela e Pasurisë së Paluajtshme	√	1,007,760	
10	SABA	ADEM	ZIRA		3599 THUMANË	26/2	ARË	2280	2280	442	1,007,760		Kartela e Pasurisë së Paluajtshme	√	1,007,760	
11	SABA	ADEM	ZIRA		3599 THUMANË	53/6	ARË	2300	2300	442	1,016,600		Kartela e Pasurisë së Paluajtshme	√	1,016,600	Përshkrimi i veçantë: Sek. Kons., datë.28.8.2017, N. 822276 "TS" sh.p.k.
12	ASTRIT	ADEM	ZIRA		3599 THUMANË	53/5	ARË	2300	2300	442	1,016,600		Kartela e Pasurisë së Paluajtshme	√	1,016,600	
13	ZIM	NEZIR	ZIRA		3599 THUMANË	53/4	ARË	1550	1550	442	685,100		Kartela e Pasurisë së Paluajtshme	√	685,100	
14	NAFIE ALMA EGLANTINA TEUTA ALFRED SONILA KLEVIS	SALI ISMAIL ISMAIL ISMAIL ISMAIL ISMAIL	ZIRA ZIRA ZIRA ZIRA ZIRA ZIRA		3599 THUMANË	53/3	ARË	2040	2040	442	901,680		Kartela e Pasurisë së Paluajtshme	√	901,680	
15	XHEMAL	ADEM	ZIRA		3599 THUMANË	53/2	ARË	1650	1650	442	729,300		Kartela e Pasurisë së Paluajtshme	√	729,300	
16	MEREMË	TARE	ZIRA		3599 THUMANË	53/1	ARË	5620	5620	442	2,484,040		Kartela e Pasurisë së Paluajtshme	√	2,484,040	
17	BASHKIA KRUIJE				2182 KODËR THUMANË	122/3	ARË	6000	0	362	-	-	Kartela e Pasurisë së Paluajtshme	√	-	
18	XHAFER	MUSTAFA	NUZI		3599 THUMANË	122/2	ARË	9000	9000	442	3,978,000		Kartela e Pasurisë së Paluajtshme	√	3,978,000	
19	ARBEN	VATH	UKA		2182 KODËR	122/1	ARË	2685	2685	362	971,970		Kartela e Pasurisë së Paluajtshme	√	971,970	Aktë 108, datë 31.1.1997 Tipi: Përdorim

20				SHTET	THUMANË 2182 KODËR THUMANË	123	KULLOTË	9100	0	362	-		Kartela e Pasurisë së Paluajtshme	-	Aben Vath Uka
21				SHTET	3599 THUMANË	50/2	VRESHT	10800	0	442	-		Kartela e Pasurisë së Paluajtshme	-	Mbi këtë pasuri ndodhet ndërtesa me nr. 50/3, vol. 8, f. 171 dhe ndërtesa nr. 50/4, vol. 8, f. 220 Ndërtesat mbi këtë pasuri ndodhen në pjesën e parcelës që nuk preket nga projekti (ndodhen jashtë gjurmës së projektit).
22				SHTET	3599 THUMANË	51/15	ARË	32350	0	442	-		Kartela e Pasurisë së Paluajtshme	-	Mbi këtë pasuri ndodhet ndërtesa me nr. 51/27, vol. 8, f. 210; ndërtesa nr. 51/28, vol. 8, f. 220 dhe ndërtesa nr. 51/29, vol. 8, f. 221. Këto ndërtesa janë jashtë zonës së projektit. Ndërtesat mbi këtë pasuri ndodhen në pjesën e parcelës që nuk preket nga projekti (ndodhen jashtë gjurmës së projektit).
23	SABA	ADEM	ZIRA		3599 THUMANË	51/15/1	OBJEKT SOCIAL EKONOMIK	127	0					-	Ndërtesë në proces legalizimi Informacioni është sipas deklaratës së subjektit e dërguar nga ASHK Krujë, genplani bashkëlidhur vendimit për përjashtim nga legalizimi dhe procesverbalit të matjeve në terren. Kjo ndërtesë ndodhet mbi parcelën me nr. 51/15, me pronar Shtetin.
24	KASTRIOT	NIKOLL	LEGISI		3599 THUMANË	12/3/1	NDËRTESESË	277	0					-	Ndërtesë në proces legalizimi. Ndërtesë 2-katëshe në ndërtim, me sipërfaqe 114 m ² në secilin kat plus ballkonet e kati të dytë. Informacioni është sipas deklaratës së subjektit e dërguar nga ASHK Krujë, genplani bashkëlidhur vendimit për përjashtim nga legalizimi dhe procesverbalit të matjeve në terren. Kjo ndërtesë ndodhet mbi parcelat me nr. 12/7 dhe 12/3, me pronar privat.
25				SHTET	3599 THUMANË	161	KANAL	2900	0				Kartela e Pasurisë së Paluajtshme	-	
26				SHTET	2182 KODËR THUMANË	359	KANAL	3000	0				Kartela e Pasurisë së Paluajtshme	-	
SHUMA TOTALE								118,009	47,055	20,583,510	348,529	20,932,039			